

VENDIM
Nr. 202, datë 1.9.2025

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” SHPK,
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET PRODHUES 12 MW**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.9.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2122/10 prot., datë 28.8.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Global Technical Mechanics’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Global Technical Mechanics” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2122 prot., datë 18.7.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 12 mw, me vendndodhje në zonën e Aeroportit të Kukësit, Njësia Administrative Shtiqen, Bashkia Kukës, qarku Kukës.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 172, datë 31.7.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.8.2025 dhe 2.8.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 11.8.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua në dy gazeta zyrtare, në rrjetet sociale të institucionit edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 2122/3 prot., datë 5.8.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të munguar.

- Nëpërmjet shkresës nr. 2122/4 prot., datë 5.8.2025, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, ku i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe për shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.

- Shoqëria, pas dorëzimit të dokumentacionit plotësues, me shkresat nr. 2122/5 prot., datë 13.8.2025 dhe nr. 2122/7 prot., datë 26.8.2025, si dhe pas kërkesave të ERE-s (shkresën me nr. 2122/6 prot., datë 18.8.2025 dhe *e-mail*, datë 26.8.2025), shoqëria në datën 28.8.2025 ka depozituar dokumentacionin e plotë të aplikimit.

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 175, datë 20.3.2025, është miratuar ndërtimi i centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike për vetëprodhim dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është

objekt koncesioni, në zonën e Aeroportit të Kukësit, Njësia Administrative Shtiqen, Bashkia Kukës, qarku Kukës, nga shoqëria “Global Technical Mechanics” sh.p.k.

- Shoqëria ka nënshkruar me MIE-n kontratën nr. 2718 rep., nr. 1082 kol., datë 23.5.2025, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike për vetëprodhim, me kapacitet prodhues 12 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën e aeroportit të Kukësit, Njësia Administrative Shtiqen, Bashkia Kukës, qarku Kukës, nga shoqëria “Global Technical Mechanics” sh.p.k.

- Me shkresën e OSSH sh.a., nr. 10278/3 prot., datë 3.10.2024, është miratuar pika e lidhjes e centralit fotovoltaike me rrjetin e shpërndarjes.

- Shoqëria është pajisur me vendim për VNM Paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), më 11.10.2024, për ndërtimin e impiantit fotovoltaike me fuqi 12 mw.

Kushtet dhe afatet ligjore:

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Duke qenë se shoqëria ka bërë me dije se jetëgjatësia e pritshme e centralit është 25 vjet, edhe vlefshmëria e licencës do të jetë për 25 vjet, referuar parashikimeve ligjore dhe afateve përkatëse të dokumenteve të aplikimit.

- Shoqëria aktualisht disponon një VNM të vlefshme deri më 11.10.2026, e cila ndodhet brenda afateve të përcaktuara në kontratën me MIE-n, ku përcaktohet se duhet të ndërtojë dhe të vendosë në punë centralin brenda datës 20.3.2028. Në këto rrethana dhe duke marrë në konsideratë faktin se vetë shoqëria ka parashikuar që të vendosë në operim centralin brenda muajit dhjetor 2025, vlerësohet që t’i lihet detyrë asaj për të filluar ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31.12.2025.

- Po ashtu, në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës së nënshkruar me MIE-n vlerësohet që shoqërisë t’i lihet kusht që me fillimin e operimit/ushtimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, por jo më vonë se 60 ditë nga ky fakt, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin e veprës.

- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi, në rast të depozitimit të sa lënë detyrë shoqërisë dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Global Technical Mechanics” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 12 mw, me vendndodhje në zonën e Aeroportit të Kukësit, Njësia Administrative Shtiqen, Bashkia Kukës, qarku Kukës, për një afat 25-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31.12.2025.

3. Me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.

4. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Global Technical Mechanics” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OSSH sh.a., dhe ALPEX sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti